



BULETIN

BULETIN I OEMVP

KUARTALI I PARË

Janar – Mars 2023

Shkup, Maj 2023

Përmbajtja

Hyrje.....	4
1. Zbatimi i drejtë i legjislacionit si parakusht për shtetin e së drejtës dhe formalizimi i ekonomisë gri	5
1.1 Takim pune – Kryetari i OEMVP z. Qyra priti zv. Kryeministrin për çështje ekonomike dhe kabinetin e Tij.....	5
1.2 Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra së bashku me Drejtorin ekzekutiv ishin pjesëmarrës në takimin e Komisionit për “Dialog Publiko-Privat”	5
Informatori ligjor JURIS dhe JURIS ALARM	6
3. Nxitja e sipërmarrësisë, inovacionit dhe rritja e konkurrueshmërisë vendore dhe rajonale të kompanive anëtare	7
3.1 OEMVP organizoi infosesionin me FIZHT, thirrja “Me transformim digjital deri ne inovacione”. 7	
3.2 OEMVP në vizitë tek odat partnere në Kosovë.....	7
3.3 Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra së bashku me anëtarët e kryesisë në takim në Qeverinë e Republikës së Kosovës	8
3.4 Kryetari i OEMVP prezent në ngjarjen e Fondacionit për Zhvillimin e Arsimit dhe Kulturës ALBIZ ku u promovua gjenerata e 12 bursistëve	8
3.5 Përfaqësuesit e Grupacionit për Turizëm dhe Hotelieri pjesë e takimit të punës në Ministrinë e Ekonomisë.....	9
3.6 OEMVP fuqizon gruan në biznes.....	9
Informatori ekonomik ECONOMICUS	10
4. OEMVP – Odë me kredibilitet dhe prestigj, e aftë për të tërhequr anëtarë të ri nëpërmjet organizimit efektiv dhe profesional	11
4.1 CCIT Awards 2023- Anëtarët e OEMVP fitues të çmimeve	11
4.2 OEMVP, punëtori në përpilimin e planit vjetor 2023	11
4.3 OEMVP mban mbledhjen e Dytë të Këshillit Drejtues	12
4.4 Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra në takim me kryetarin e SHRBSH-së	12
4.5 Nënshkruhet Marrëveshje për partneritet strategjik në mes OEMVP-SË dhe UBO CONSULTING	13

4.6 OEMVP - Sofra Tradicionale e Iftarit	13
4.7 Promovimi i anëtarëve të OEMVP – Ndërmarrësi i javës	14
5. Marrëdhëniet me publikun	15
6. Komunikim me anëtarët	17
7. OEMVP në media	17
8. OEMVP në rrjetet sociale	18
9. OEMVP në faqen zyrtare	18

Hyrje

Buletini i OEMVP është dokument i cili publikohet në baza kuartale dhe i cili përmban përshkrim të shkurtuar të aktiviteteve të OEMVP-së për periudhën e raportimit. Në kuartalin e parë, gjegjësisht periudhën Janar – Mars 2023 OEMVP me qëllim të realizimit të vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike afatgjate të OEMVP-së ka organizuar aktivitete të ndryshme duke vazhduar të etablohet si një institucion i mirëfilltë dhe profesional i drejtuar në përkrahjen dhe avancimin e bizneseve në vend dhe më gjerë.

Strategjia e OEMVP-së për vitin 2020 – 2023 është e bazuar mbi kontekstin e përgjithshëm, nevojat prioritare, aktivitetet e aktorëve tjerë si dhe mbi rolin e vet, dhe ka të definuara pesë objektiva strategjike. Bazuar në vizionin dhe misionin, po ashtu edhe në qëllimet afatgjate të Odës, gjatë kësaj periudhe jemi angazhuar në arritjen e këtyre qëllimeve strategjike:

1. Zbatimi i drejtë i legjislacionit si parakusht për shtetin e së drejtës dhe formalizimi i ekonomisë gri;
2. Resurset humane si shtyllë kryesore e çdo biznesi;
3. Nxitja e sipërmarrësisë, inovacionit dhe rritja e konkurrueshmërisë vendore dhe rajonale të kompanive anëtare;
4. OEMVP – Odë me kredibilitet dhe prestigj, e aftë për të tërhequr anëtarë të ri nëpërmjet organizimit efektiv dhe profesional;

Si qëllim horizontal, i cili përputhet me të gjitha qëllimet tjera, OEMVP promovon zhvillimin e barabartë rajonal.

OEMVP ka dëshmuar edhe njëherë që gjithmonë është në përkrahje të bizneseve, duke lobuar dhe ndryshuar disa vendime të cilat mund të shkojnë në dëm të bizneseve.

Durim Zekiri

U.D. Drejtor Ekzekutiv

1. Zbatimi i drejtë i legjislacionit si parakusht për shtetin e së drejtës dhe formalizimi i ekonomisë gri

Në kuadër të përcaktimit strategjik “Zbatimi i drejtë i legjislacionit si parakusht për shtetin e së drejtës dhe formalizimin e ekonomisë gri”, për arritjen e qëllimeve të definuara sipas misionit dhe vizionit të Odës, gjatë periudhës Janar - Mars 2023 OEMVP ka realizuar aktivitetet në vijim.

1.1 Takim pune – Kryetari i OEMVP z. Qyra priti zv. Kryeministrin për çështje ekonomike dhe kabinetin e Tij



27.01.2023, Shkup – Në këtë takim të zhvilluar në hapësirat e OEMVP-së, u bisedua rreth çështjeve aktuale ekonomike të vendit si dhe për mundësitë e tejkalimit të të njëjtave nëpërmjet bashkëpunimit të ndërsjellë mes institucioneve qeveritare dhe OEMVP-së. Ndër temat të cilat u diskutua ishin edhe energjetika, fuqia punëtore, ndërtimtaria, doganat si dhe konkurrenca jo lojale, nga

të cilat kompanitë janë më shumë të prekura, por gjithashtu edhe çështja e hapur e bizneseve të dëmtuara nga vërshimet e 2016 në Hasanbeg të Shkupit.

Këtë takim e kryesoi Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra, ndërsa prezent ishin edhe kryesia e Odës të cilët përfaqësuan grupacionet dhe sektorët ekonomik të OEMVP-së.

Ky është fillimi i takimeve me politikë bërësit të cilat Kryetari Qyra do të zhvillon në mandatin e tij, kështu duke realizuar programin e tij 4 vjeçar në përputhshmëri me përcaktimet strategjike të OEMVP-së.

1.2 Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra së bashku me Drejtorin ekzekutiv ishin pjesëmarrës në takimin e Komisionit për “Dialog Publiko-Privat”



16.02.2023, Shkup – Në këtë takim u diskutua mbi disa tema, ndër të cilat ishin edhe: Importi i fuqisë punëtore, Ligji për marrëdhëniet e punës, reformat tatimore, Kriza energjetike dhe Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve.

OEMVP shpalosi kërkesat e saja të cilat gjithmonë kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj dhe avancimin e të njëjtëve përmes krijimit të ambientit më të favorshëm të të bërit biznes.

Informatori ligjor JURIS dhe JURIS ALARM

Gjatë kësaj periudhe OEMVP publikoi 4 edicione të Informatorëve ligjor JURIS dhe JURIS ALARM.

Temat që u publikuan në këto informator ligjorë janë:

JURIS:

- **JURIS NR. 1** - Vendim për heqjen e detyrimeve të importit – detyrime doganore për importin e makaronave dhe VENDIM për përcaktimin e çmimeve më të larta për produkte të veçanta në tregtinë me pakicë.

JURIS ALARM:

- **JURIS ALARM NR. 1**- Ligji për ratifikimin e marrëveshjes për kushtet e qasjes së lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor.
- **JURIS ALARM NR. 2**- Vendim për përcaktimin e çmimeve më të larta për produktet të caktuara në tregtinë me pakicë.
- **JURIS ALARM NR.3** – Vendim për përcaktimin e çmimeve më të larta për produktet e caktuara në tregtinë me pakicë dhe obligimin e tregtarëve për blerjen dhe shitjen e llojeve dhe sasive të caktuara të mallrave të caktuara tek konsumatorët sipas një radhitje të caktuar.

3. Nxitja e sipërmarrësisë, inovacionit dhe rritja e konkurrueshmërisë vendore dhe rajonale të kompanive anëtare

3.1 OEMVP organizoi infosesionin me FIZHT, thirrja “Me transformim digjital deri ne inovacione”



31.01.2023, Shkup – Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore me Fondin për Inovacione dhe Zhvillim teknologjik së bashku me Increasing Market Employability, organizuan një sesion informativ për sfidën “Me transformimin digjital deri në inovacione”. Në këtë infosesion morën pjesë ndërmarrje nga sektori i agro-ushqimit anëtare të OEMVP-së, të cilët patën

mundësinë të njihen më hollësisht me kushtet dhe kriteret e sfidës nga ekipi i FIZHT dhe IME.

Drejtori Ekzekutiv i OEMVP-së z. Drilon Iseni në fjalën e tij potencoi se transformimi digjital gjegjësisht, digjitalizimi është element kyç për biznesin dhe ekonominë posaçërisht në vitet e fundit ku konkurrueshmëria është duke u forcuar në tregun vendor, regjional por edhe atë botërorë dhe nëse ekonomia jonë arrin të mban hapin me shtetet më të zhvilluara, do të arrijë vetëm nëpërmjet digjitalizimit apo transformimit digjital dhe inovacioneve.

3.2 OEMVP në vizitë tek odat partnere në Kosovë



02.02.2023 - Më 1 Shkurt 2023, Kryetari Mendi Qyra së bashku me kryetarin e Forumit Ekonomik Mbarë Shqipëtar z. Nagib Fejzi me përfaqësues tjerë të bordit dhe të zyrës ekzekutive të OEMVP, ishte në vizitë në Kosovë tek odat partnere.

Takimet filluan tek Dhoma e tregtisë dhe industrisë Kosovë, ku u mirëpritën nga Kryetari z. Skender

Krasniqi dhe përfaqësues tjerë të bordit. Përgjatë këtij takimi u diskutuan sfidat e shumta të përbashkëta të cilat bizneset e RMV-së dhe të RKS-së i hasin në përditshmërinë e tyre, si dhe u fol mbi atë se si odat në bashkëpunim me njëra tjetrën mund të ndikojnë në eliminimin e të njëjtave. Nisur nga kjo, delegacioni i OEMVP-së vazhdoi në realizimin e takimit të dytë në agjendë me Aleancën Kosovare të Bizneseve, ku u mirëpritën nga kryetari i saj z. Agim Shahini si dhe përfaqësues tjerë të trupit udhëheqës të AKB-së. Kryetari Qyra në këtë takim potencoi se potenciali i shkëmbimit tregtar mes dy vendeve është larg realizimit të plotë, dhe se duhet të punohet në drejtim të maksimizimit të saj përmes eliminimit të barrierave të cilat pengojnë një bashkëpunim të fuqishëm ekonomik mes dy vendeve.

3.3 Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra së bashku me anëtarët e kryesisë në takim në Qeverinë e Republikës së Kosovës



21.02.2023, Shkup - Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra së bashku me anëtarët e kryesisë ishin në takim në Qeverinë e Republikës së Kosovës ku u mirëpritën nga zëvendës Kryeministri i parë për Integritet Evropian, zhvillim dhe dialog z. Besnik Bislimi. Qëllimi i këtij takimi ishte shtjellimi i çështjeve dhe barrierave të cilat pengojnë zhvillimin ekonomik të mëtejshëm dhe arritjen

e potencialit të shkëmbimit tregtar mes dy vendeve respektive.

Gjithashtu, u shpalosën edhe shumë probleme të cilat kanë të bëjnë me ekonominë, ku ndër tjerash kryetari i OEMVP-së z. Qyra, prezantoi edhe disa pika të cilat duhet të fokusohemi, si: Partneritet afatgjatë mes Odave dhe Institucioneve të vendeve përkatëse; Bashkëpunimi mes vendeve respektive në rrafshin ekonomik dhe përmirësimin e klimës të të bërit tregti mes dy vendeve; Integrimi i tregjeve në një treg të përbashkët; Liberalizimi i tregut të fuqisë punëtore; One Stop Shop në kufijtë dhe doganat; Eliminimi i plotë i barrierave jo tarifore dhe Integrimi i plotë rajonal ekonomik, si probleme me të cilat ballafaqohen bizneset nga të dyja vendet sa i përket veprimtarisë afariste.

3.4 Kryetari i OEMVP prezant në ngjarjen e Fondacionit për Zhvillimin e Arsimit dhe Kulturës ALBIZ ku u promovua gjenerata e 12 bursistëve



22.02.2023, Shkup – Kryetari i OEMVP ishte prezent në ngjarjen e Fondacionit për Zhvillimin e Arsimit dhe Kulturës ALBIZ ku u promovua gjenerata e 12 bursistëve . Nisur nga kjo, Kryetari Qyra ceki se përkrahja e studentëve dhe profesionistëve të rinj duhet të jetë e prioritetit të lartë marrë parasysh fluksin e madh të shpërnguljes që ndodh në vend dhe rajon. Gjithashtu, jemi ithtarë të zhvillimit të arsimit dhe kulturës, si dy elemente kyçe që kontribuojnë në formësimin e të rinjve por edhe në përcaktimin e kahjes se nga do të shkojë shoqëria jonë.

Ne si institucion e përshëndesim çdo iniciativë dhe projekt të këtij karakteri, e sidomos këtë ngjarje madhështore të Fondacionit Albiz i cili tregon që bizneset tona në vend, janë shumë të vetëdijshme por edhe të shqetësuara për problemet me të cilat përballen rinia jonë. Andaj i përgëzoj bizneset, ndërsa bursistëve tanë ju uroj sukses duke shpresuar se ngritja e tyre profesionale do i shërbejë komunitetit dhe shoqërisë ku ata veprojnë, nëpërmjet vlerës së shtuar që sjellin me kontributin e tyre.

3.5 Përfaqësuesit e Grupacionit për Turizëm dhe Hotelieri pjesë e takimit të punës në Ministrinë e Ekonomisë



24.02.2023, Shkup - Nënkryetari i OEMVP-së z. Shpresim Tairi dhe Anëtari i Këshillit Drejtues z. Trim Qemali, si përfaqësues të Grupacionit për Turizëm dhe Hotelieri pranë OEMVP ishin pjesë e takimit të punës në Ministrinë e Ekonomisë. Ky takim kishte për qëllim Përgatitjen e strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për zhvillimin e turizmit të Republikës së

Maqedonisë së Veriut për vitin 2024-2028 si dhe për Ndryshimet ligjore që parashihen në pjesën e Ligjit për turizëm dhe Ligjit për veprimtaritë hotelierike të cilët kanë për qëllim përmirësimin e rregullativës ligjore, respektimit të direktivave evropiane dhe digjitalizimit të procedurave.

Në këtë takim përfaqësuesit e OEMVP shpalosën kërkesat dhe qëndrimet e Odës në lidhje me rregullativën ligjore që tangon këto sektorë, të cilat janë në mbështetje të të njëjtave duke qenë se efektet e pandemisë Covid-19 ende po ndjehen në këtë veprimtari.

3.6 OEMVP fuqizon gruan në biznes



08.03.2023, Shkup – Grupacioni i Grave Afariste pranë Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore dhe Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore, në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, organizuan Konferencën e 8 Marsit me temë “Roli i gruas në shoqëri dhe biznes.

Konferenca u fokusua në rolin e grave në shoqëri dhe Kryetari i OEMVP, z. Mendi Qyra, Drejtori ekzekutiv z.

Drilon Iseni dhe Profesori i UEJL, z. Veland Ramadani, përmes fjalës së tyre në konferencë u fokusuan tek rëndësia e rolit të grave në shoqëri dhe biznes, duke theksuar se gruaja është palca e shoqërisë dhe se fuqizimi i saj është i rëndësishëm jo vetëm për aspektin social, por edhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

3.7 OEMVP realizoi takim me përfaqësues të komunës së Preshevës



15.03.2023, Shkup - OEMVP realizoi takim me nënkryetarin e komunës së Preshevës z. Almin Shaqiri dhe drejtorin e zyrës për zhvillim ekonomik lokal z. Driton Bina ku u mirëpritën nga Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra dhe përfaqësues tjerë.

Në këtë takim u diskutua rreth iniciativës për krijimin e zonës ekonomike në Preshevë, klimës së

investimeve dhe bashkëpunimit mes Odës dhe institucionit në fjalë përsa i përket projekteve ekonomike afariste, dhe potencialit të tyre.

OEMVP dhe kryetari i saj Qyra shprehën gatishmëri për asistim dhe përkrahje në koncipimin e kësaj zone të rëndësishme për atë regjion.

OEMVP si gjithmonë është në dispozicion të bizneseve të cilët duan të zgjerojnë veprimtarinë e tyre afariste, duke synuar zhvillim ekonomik vendor por edhe rajonal.

Informatori ekonomik ECONOMICUS

Gjatë kuartalit të parë të vitit 2023 është publikuar 1 edicion i informatorit ekonomik ECONOMICUS. Tema e cila është prezantuar në këtë informatorë ekonomik është:

- **Economicus nr. 1** –Tregtia e jashtme e Maqedonisë së Veriut në periudhën Janar-Dhjetor 2022.

4. OEMVP – Odë me kredibilitet dhe prestigj, e aftë për të tërhequr anëtarë të ri nëpërmjet organizimit efektiv dhe profesional

4.1 CCIT Awards 2023- Anëtarët e OEMVP fitues të çmimeve



01.02.2023, Shkup – Në manifestimin e 126 vjetorit të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, OEMVP kishte vend të veçantë në këtë organizim. Në këtë manifestim u vlerësuan me çmime 3 ndër sipërmarrjet më të suksesshme anëtare të Odës, MI-TRANS, GIPS IMOBILIA DESIGN DHE SILCAPOR kurse çmimet për të njëjtët i ndau Kryetari i Forumit Ekonomik Mbarë Shqiptar z.Nagib Fejzi. Po ashtu, vend i veçantë iu kushtua Kryetarit të OEMVP z. Mendi Qyra i cili ndau çmime për sipërmarrës shqiptar të tjerë, që kanë shënuar arritje gjatë vitit 2022.Me këtë rast OEMVP falënderon kryetarin e Dhomës tregtisë dhe industrisë Tiranë

z.Nikolin Jaka për konsideratën ndaj OEMVP.

4.2 OEMVP, punëtori në përpilimin e planit vjetor 2023



15.02.2023, Shkup – OEMVP përpiloi planin vjetor të aktiviteteve për vitin 2023 në një punëtori të mbajtur në hapësirat e anëtares së saj Hotel Mercure. Në këtë punëtori, morën pjesë Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra, kryesia si dhe anëtarë tjerë nga organet e saja, ndërsa u udhëhoq nga Drejtori Ekzekutiv dhe Menaxheri operativ. Ky plan vjetor, u përpilua në bazë të përcaktimeve strategjike të strategjisë së OEMVP-së 2020-2023, duke qëndruar në përputhshmëri me vizionin dhe misionin e saj në drejtim të përmirësimit të klimës të të bërit biznes në vend por edhe më gjerë. OEMVP vazhdon të kontribuojë në përmirësimin e aspektit socio ekonomik të

vendit nëpërmjet realizimit të projekteve dhe aktiviteteve të saja.

4.3 OEMVP mban mbledhjen e Dytë të Këshillit Drejtues



22.02.2023, Shkup – Më datë 21 Shkurt 2023, në hapësirat e OEMVP-së u mbajt mbledhja e II e Këshillit Drejtues. Ndër pikat e rendit të ditës, ishin edhe Aprovimi i Protokollit të OEMVP-së, si dhe shqyrtimi dhe aprovimi i Planit Vjetor të aktiviteteve. Këshilli Drejtues i OEMVP-së u udhëhoq nga Kryetari Mendi Qyra, ndërsa të pranishëm ishin pjesa më e madhe e anëtarëve të organit.

OEMVP në nivel vjetor mban Takime të rregullta të organeve përkatëse udhëheqëse si të Këshillit drejtues ashtu edhe të atij Mbikëqyrës.

4.4 Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra në takim me kryetarin e SHRBSH-së



16.02.2023, Shkup – Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra dje ishte i pranishëm në ambientet e Bujtinës Panorama Dajt, ku u mirëprit nga kryetari i SHRBSH-së z. Kujtim Dervishi gjatë së cilës u nënshkrua një marrëveshje për bashkëpunimin mbi aktivitetet e përbashkëta ndërmjet "Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore" dhe "Shoqata

Restoranteve Bujtinave Shqiptare"

Të dy kryetarët shprehën vullnetin dhe vendosshmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e kësaj marrëveshjeje mbi aktivitetet e përbashkëta.

Objektivi i kësaj marrëveshjeje është zhvillimi i marrëdhënieve ndërmjet palëve duke synuar koordinimin dhe bashkëveprimin ndërmjet tyre, mbrojtjen e interesave në drejtim të promovimit të restoranteve, realizimin e seminareve, trajnimeve, organizimin e panairove të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit.

4.5 Nënshkruhet Marrëveshje për partneritet strategjik në mes OEMVP-SË dhe UBO CONSULTING



23.02.2023, Shkup - Sot, në Shkup, është nënshkruar Marrëveshje për partneritet strategjik në mes Odës Ekonomike së Maqedonisë Veri-Perëndimore dhe kompanisë UBO-Consulting, që ka për qëllim fuqizimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të anëtarëve të OEMVP-së duke u bazuar në të dhëna që dalin nga shërbimet cilësore në fushën e hulumtimeve të

tregut, të analizës dhe vizualizimit të tyre.

Përmes këtij bashkëpunimi, synohet që UBO Consulting të ndihmojë anëtarët e OEMVP-së në konceptimin dhe zhvillimin e hulumtimeve në tema dhe sektorë me interes të përbashkët në mënyrë që kompanitë anëtare të identifikojnë tregje të reja potenciale për produktet dhe shërbimet e tyre.

4.6 OEMVP - Sofra Tradicionale e Iftarit



30 Mars 2023, Shkup – U mbajt Sofra e Iftarit, të cilën tradicionalisht, vite me radhe e organizon OEMVP, gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit. Përpos anëtarësisë së OEMVP-së, të pranishëm ishin edhe Kryetari i Kuvendit, z. Talat Xhaferi, ministra, përfaqësues të BFI-së, Ambasadorë, kryetarë komunash, kryetarë të partive politike, Oda ekonomike vendore dhe rajonale, media si dhe

përfaqësues të institucioneve të ndryshme në vend.

Në fjalën e tij, kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra potencoi rëndësinë dhe kuptimin e muajit të shenjtë të Ramazanit si muaj të solidaritetit që na afron më tepër. Mesazhi kryesor që u përcoll ishte domosdoshmëria e unitetit, humanizmit, mirënjohjes, sundimit të paqes, lumturisë dhe dashurisë ndaj njëri-tjetrit, përkatësisht një mesazh që mbart vetë muaji i shenjtë i Ramazanit. OEMVP vazhdon të jetë shtyllë e mbrojtjes së interesave të biznesit si dhe lider në organizimin e ngjarjeve të mëdha të interesit publik me karakter ekonomik.

4.7 Promovimi i anëtarëve të OEMVP – Ndërmarrësi i javës

Së bashku me Telegrafi Maqedoni këtë vit kemi nisur edhe emisionin për ndërmarrësit e javës me kompanitë anëtare të OEMVP-së. Gjatë kuartalit të parë të vitit 2023 janë publikuar 4 emisione:

- **08.03.2023** – Dauti - Komerc
<https://www.youtube.com/watch?v=0TWNJD9d0EA>
- **15.03.2023** – BE-DA Logistics
https://www.youtube.com/watch?v=uA_FG5dCSkA
- **22.03.2023** – Vardar Dolomit
<https://www.youtube.com/watch?v=tRAPbUT2b24>
- **30.03.2023** – M-Sora
<https://www.youtube.com/watch?v=J-QMtrWiyqw>

5. Marrëdhëniet me publikun

- **27.03.2023** – Durim Zeqiri në deklaratën e tij shpalos qëndrimin e OEMVP-së rreth llogaritjes verore të kohës. Të njëjtën mund ta dëgjoni në videon e mëposhtme.
<https://www.facebook.com/oemvp.org/videos/612404184087605/>
- **21.03.2023** – Konferenca për shtyp e OEMVP-së e udhëhequr nga Kryetari z. Mendi Qyra.
<https://www.facebook.com/oemvp.org/videos/1941559132852609>
- **10.03.2023** – Kryetari i OEMVP-së z. Qyra: MIRATIMI I KORRIDORIT 8 DHE 10-D, I RËNDËSISHËM, NJËKOHSISHTË EDHE I VONUAR
<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid02yJ6KXPDkxxS4jYuVzNF3Eo3s2M4heda7iSfGgLZh5PFqSN1FWu4WqSfRNfeELRdsI>
- **10.03.2023** Kryetari i OEMVP-së z. Mendi Qyra, në prononcimin e tij të sotëm, flet për Koridorin 8 dhe 10D, gjegjësisht mbi rëndësinë ekonomike të këtij projekti infrastrukturor.
<https://www.facebook.com/www.indeks.mk/videos/2256214834562931>
- **09.03.2023** Ndiqni Live Drejtorin ekzekutiv të OEMVP-së në lidhje me temën “Sfidat e biznesit të huaj dhe vendas,,
<https://www.facebook.com/KlanMacedoniaTelevision/videos/2103048903418689>
- **07.03.2023** "Qeveria të gjejë mënyra alternative, si t'i ulë çmimet e produkteve të caktuara ushqimore, qofshin ato bazë apo në përgjithësi" - Drilon F. Iseni drejtori ekzekutiv i OEMVP-së, tha ndër tjerash në deklaratën e tij për Radio Evropa e Lirë. Për më tepër, lexoni deklaratën në lidhësen vijuese.
<https://www.evropaelire.org/a/ngirja-e-cmimeve-kercenimet-e-prodhuesve-maqedoni-/32304380.html?fbclid=IwAR0VRKrSSufleCYWsJMoqvZ-7q1v50Kx-mONgaOI9POUxPftgEzNZ6Xse8>
- **02.02.2023** Delegacioni nga Maqedonia e Veriut kryesuar nga kryetari i OEMVP, Mendi Qyra vizitë te Aleanca Kosovare e Bizneseve ku u pritën nga kryetari i AKB z. Agim Shahini i cili shprehi gadishmëri për ri-fillimin e një bashkëpunimi.
<https://vimeo.com/794888669?ref=fb-share&fbclid=IwAR0QFVjpA5OxDX05kKV7cc6Y3wX505EirOBI7byOajqrtBY0ZqgFHtOwqRg>

- **23.01.2023** Drejtori Ekzekutiv i OEMVP-së Drilon Iseni live në Tv24, debaton rreth kushteve të të bërit biznes për kompanitë vendore.

<https://www.facebook.com/24vesti.mk/videos/465499965794139>

- **11.01.2023** Deklarata e Drejtorit Ekzekutiv të OEMVP-së, z. Drilon Iseni për Mia.mk

"Qeverisë i nevojitet vizion i qartë në drejtim të gjetjes së zgjidhjeve për krizat"

https://mia.mk/%D0%B1%D0%B8%D0%B7%D0%BD%D0%B8%D1%81%D0%BE%D1%82-%D0%B2%D0%BE-2023-%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D0%B0-%D0%BE%D1%87%D0%B5%D0%BA%D1%83%D0%B2%D0%B0-%D1%81%D1%82%D1%80%D1%83%D0%BA%D1%82%D1%83%D1%80/?fbclid=IwAR2IcR77qoIEjCuT2Z59I6C29HWhbDfDYHQWj2yS5c1_c3MlzBly5fNb8ks

6. Komunikim me anëtarët

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2023, Desku i shërbimeve ka realizuar 2700 kontakte me kompani në forma të ndryshme (thirrje telefonike dhe e-mail).

Gjatë tremujorit të parë, në OEMVP janë anëtarësuar gjithsej 16 kompani të reja.

7. OEMVP në media

Gjatë periudhës Janar – Mars 2023, përfaqësues të OEMVP kanë qenë prezent në media 20 herë, ndër të cilat

- në emisione – 5 herë;
- deklarata në TV – 10 herë;
- deklarata në media të shtypura – 5 herë;


Gjithashtu, gjatë periudhës së njëjte OEMVP është cituar – mbi 130 herë.

8. OEMVP në rrjetet sociale

OEMVP, me përfundimin e kuartalit të parë të vitit 2023, në rrjetin social FACEBOOK numëron gjithsej:

- 7,823 ndjekës;
- 7,475 pëlqime të profilit.

Krahasuar me vitin paraprak, periudhën e njejtë kemi rritje të pëlqimeve të profilit për 4.5 %, ndërsa rritje të ndjekësve për 7.2%.



9. OEMVP në faqen zyrtare

Gjatë kuartalit të parë të vitit 2023, në bazë të statistikave, ueb faqja zyrtare e OEMVP ka gjithsej **15,716 përdorues (users)** dhe **12,399 klikime**. Në krahasim me periudhën e njejtë të vitit paraprak, numri përdorueseve është rritur për **30.0%**, ndërsa numri i klikimeve në webfaqe është zvogëluar për **27.4%**. Ndjekësit kryesisht janë nga Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria.



Vizioni

OEMVP synon që të bëhet organizatë lider në përfaqësimin e interesave të bizneseve si dhe krijimin e mjedisit të përshtatshëm për zhvillim.

Misioni

OEMVP bën organizimin, avancimin, mbrojtjen e interesave dhe promovimin e bizneseve në vend dhe jashtë, përkrah sfidave të konkurrencës globale.

Kontakt

 info@oemvp.org

 02 3239 252

 Rr. Dimitrie Cupovski, nr. 13, Shkup